



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “AS Term” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810833196 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Rafet Ferizi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Osmani Holding” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810145658 dhe seli në Torinë, Komuna e Lipjanit, rr. “Ismet Asllani”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 660/21, i lejuar me datë 31.05.2021, nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, pas mbajtjes se seancës dëgjimore të datës 19.10.2023, me datë 20.10.2023, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Osmani Holding” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810145658, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 660/21, i lejuar me datë 31.05.2021, nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 660/21, i lejuar me datë 31.05.2021, nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

#### A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 368/20, e datës 09.09.2020 si dhe Faturës nr. 300/20, e datës 30.07.2020, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 660/21, të datës 31.05.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të borxhit sipas faturave, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 6,009.37 me kamatë ligjore prej 8% në vit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjore e ka kundërshtuar urdhrin për përbarim, me arsyetim se dokumentet mbi bazën e së cilave është lejuar u njejtë kanë të meta të cilat i bëjnë jo të besueshme dhe të papërshtatshme për zbatimin e përbarimit, ngase ka mospërputhje në mes të kartelës financiare të prezantuar nga kreditori me kartelën financiare të debitorit, ashtu që borxhi nuk është pasqyruar në vlerën reale. Me tej, ka theksuar se disa nga faturat nuk mbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit, ndërsa të njëjtat janë në kopje. Për

këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa ka shtuar se faturat mbajnë nënshkrimin dhe vulën e debitorit dhe se të njëjtat janë dorëzuar në origjinale dhe rrjedhimisht janë të përshtatshme për përmbartim. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban asnjërin nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të shqyrtimit të valditetit të prapësimit, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, me datë 19.10.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i kreditorit, ndërsa seanca është mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të debitorit i cili, edhe përkundër që është ftuar me rregull, nuk ka prezantuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në seancë dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë propozimit dhe urdhrin për përmbartim ngase i njëjti është i mbështetur në dokumente të besueshme, rrjedhimisht në faturat objekt përmbartimi dhe marrëveshjen e palëve ndërgjyqëse. Ka shtuar se faturat për të cilat kërkohet përmbushja e detyrimit janë fatura nr. 368/20, në vlerë prej EUR 5,302.55, si dhe pjesërisht fatura 300/20, dhe atë vetëm vlera e papaguar në lartësi prej 706.82, apo shumë e përgjithshme në emër të faturave prej EUR 6,009.37. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 29. 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Faturën nr. 368/20, e datës 09.09.2020 si dhe Faturën nr. 300/20, e datës 30.07.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29.3 të LPP-së, ngase në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se faturat objekt përmbarimi derivojnë nga marrëveshja e datës 03.07.2020 për furnizim me material ndërtimor e lidhur mes palëve, këtu kreditorit dhe debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata gjen se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është real ngase nuk përputhet kartela financiare e debitorit me atë të kreditorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase debitori nuk ka bashkangjitur ndonjë provë për t'i mbështetur pretendimet e tilla në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, nenin 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 979/22, datë 20.10.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.